

TITULLI: POLITIKA E MBLEDHJES (COLLECTION POLICY)

POLITIKA DHE QËLLIMI:

Qëllimi i Politikës së Mbledhjes (Politika) është që të promovojë qasjen e pacientëve në shërbimin shëndetësor cilësor ndërkohë që minimizohet borxhi i keq në "NewYork-Presbyterian Hospital" (Spitali).

Kjo Politikë përcakton kërkesa për Spitalin si dhe agjencitë dhe përfaqësuesit ligjorë që marrin përsipër veprimtaritë e mbledhjes së borxheve, të cilat janë në përputhje me misionin, vlerat dhe parimet bazë të Spitalit, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, Politikën e Spitalit për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm ((në vijim referuar si Politika për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm (Charity Care Policy)).

ZBATUESHMËRIA:

Kjo Politikë zbatohet për Spitalin dhe çdo Agjenci, avokat ose firmë ligjore që ndihmon Spitalin në mbledhjen e një borxhi të papaguar nga llogaria e një pacienti.

PROCEDURA:

A. Udhëzime të përgjithshme

1. Spitali, agjencitë e mbledhjes (Agjencia), avokatët dhe firmat ligjore (Konsulenti i Jashtëm) pajtohen me të gjitha ligjet federale dhe kombëtare, si dhe me kërkesat e agjencisë së akreditimit që drejton mbledhjen e borxheve, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, aktin e praktikave të drejta të mbledhjes së borxheve (Fair Debt Collection Practices Act, FDCPA), aktin e faturimit të drejtë të kreditit (Fair Credit Billing Act), aktet e mbrojtjes së kreditit të konsumatorit (Consumer Credit Protection Acts), paragrafin 2807-k-9-a të ligjit "Për shëndetin publik" (Public Health Law Section 2807-k-9-a), paragrafin 501(r) të Kodit të Shërbimit të të Ardhurave të Brendshme (Internal Revenue Service Code 501(r)), nenin 52 të Ligjit dhe Rregullave të Praktikave Civile të Nju-Jorkut (Article 52 of the New York Civil Practice Law and Rules) dhe akti i mbartjes dhe llogaridhënies së sigurimit shëndetësor (Health Insurance Portability and Accountability Act, HIPAA). Gjithashtu, Spitali, Agjencia dhe Konsulenti i Jashtëm veprojnë në pajtueshmëri me Politikën e Spitalit për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm. Në rastin e ndonjë mospërputhjeje ndërmjet Politikës së Spitalit për Mbledhjen dhe Politikës për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm, mbizotëron dhe drejton Politika për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm.

2. Spitali lidh marrëveshje ligjore detyruese me shkrim, të cilat hartohen në mënyrë të arsyeshme për të parandaluar marrjen e Masave të Jashtëzakonshme të Mbledhjes (Extraordinary Collection Actions, ECAs) për përfitimin e pagesës për kujdesin shëndetësor, me çdo palë (duke përfshirë Agjencinë ose Konsulentin e Jashtëm) të cilës i transferon borxhin e një individit në lidhje me kujdesin shëndetësor, derisa të jenë bërë përpjekje të arsyeshme për të përcaktuar nëse individit kualifikohet për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm.

B. Praktikrat e mbledhjes që mund të përdoren nga Spitali dhe subjektet e autorizuar:

1. ECA-të janë masat që merr një institucion spitalor kundrejt një individit lidhur me marrjen e pagesës për kujdesin shëndetësor të mbuluar nga politika e ndihmës financiare të institucionit spitalor, siç përcaktohet në paragrafin 501(r) të Kodit të të Ardhurave të Brendshme. Në përputhje me kërkesat e kësaj Politike Mbledhjeje, Spitali mund të përfshihet vetëm në masat ECA në vijim:
 - a. Ngritjen e një padie civile,
 - b. Vendosjen e të drejtës së mbajtjes mbi një pronë
 - c. Mbajtjen ose konfiskimin e një llogarie bankare ose ndonjë pasurie tjetër personale
 - d. Pezullimin e pagave
 - e. Lëshimin e fletëthirrjeve në gjyq.
2. Spitali, Agjencia dhe Konsulenti i Jashtëm nuk mund të përfshihen në asnjë masë ECA kundrejt ndonjë pacienti ose individit tjetër që ka pranuar, ose të cilit i është kërkuar të pranojë përgjegjësi financiare për faturat e Spitalit për kujdesin ndaj pacientit, pa bërë përpjekje të arsyeshme për të përcaktuar nëse pacienti kualifikohet për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm.
3. Spitali, Agjencia ose Konsulenti i Jashtëm mund ta përcaktojnë në mënyrë të supozuar kualifikueshmërinë e një individit bazuar në informacione nga palë të treta ose në përcaktimin e mëparshëm të kualifikueshmërisë për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm. Lidhur me kujdesin shëndetësor që i ofrohet një individit, në mënyrë që të bëhen përpjekje të arsyeshme për të përcaktuar nëse një individ kualifikohet për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm, Spitali dhe Agjenti ose Konsulenti i Jashtëm, sipas rastit, mund të përcaktojnë se individit kualifikohet bazuar në informacione të ndryshme nga ato të ofruara nga individit ose bazuar në një përcaktim të mëparshëm kualifikueshmërie për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm. Më tej, nëse përcaktohet në mënyrë të supozuar se individit kualifikohet për të

NewYork-Presbyterian Hospital
Vendi: Të gjitha qendrat
Politikat e Spitalit dhe manuali i procedurave
Numri: C190
Faqja 3 nga 8

marrë më pak se ndihma më e konsiderueshme që ofrohet në përgjithësi sipas Politikës për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm, Spitali:

- a. Njofton individin në lidhje me arsyetimin për përcaktimin e supozuar të kualifikimit për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm dhe në lidhje me mënyrën e aplikimit për ndihmën më të konsiderueshme që ofrohet sipas Politikës për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm;
 - b. I jep individit një afat të arsyeshëm kohor brenda të cilit të aplikojë për ndihmë më të konsiderueshme, para se të iniciojë masat ECA për marrjen e shumës së zbritur që duhet të paguajë klienti për kujdesin shëndetësor;
 - c. Nëse individi paraqet një aplikim të plotë për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm nëpërmjet të cilit kërkon ndihmë më të konsiderueshme gjatë periudhës së aplikimit që mbulohet nga Politika për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm, Spitali, Agjencia ose Konsulenti i Jashtëm, sipas rastit, përcakton nëse individi kualifikohet për një zbritje më të konsiderueshme dhe nëse plotëson kërkesat e zbatueshme për aplikimet e plota.
4. Përpara përfshirjes në ndonjë masë ECA, Spitali bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar individin në lidhje me Politikën për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm gjatë periudhës së njoftimit, domethënë brenda 120 ditëve nga data e deklaratës së faturimit pas daljes nga spitali që Spitali i lëshon pacientit. Nëse individi nuk paraqet një aplikim për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm pasi janë bërë këto përpjekje të arsyeshme, Spitali, Agjencia ose Konsulenti i Jashtëm, sipas rastit, mund të përfshihet në masat ECA të lejuara specifikisht nga kjo Politikë (shihni procedurën A1), me kusht që Spitali të ndjekë hapat në vijim të paktën 30 ditë para zbatimit të masave ECA të lejuara nga kjo Politikë:
- a. I jep individit njoftim me shkrim, duke treguar disponueshmërinë për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm për individët e kualifikueshëm, duke identifikuar masat ECA që Spitali ose pala tjetër e autorizuar synon të ndër marrë për marrjen e pagesës për kujdes shëndetësor dhe afatin pas së cilit mund të ndërmerren këto masa ECA. Ky afat nuk caktohet më herët se 30 ditë nga dhënia e njoftimit me shkrim;
 - b. Jep një kopje të Përmbledhjes për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm (Përmbledhja) së bashku me njoftimin e parashikuar në paragrafin B4a më sipër;
 - c. Bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar individin në lidhje me Politikën për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm dhe mënyrën e

marrjes së ndihmës për procesin e aplikimit për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm gjatë çdo komunikimi telefonik midis individit dhe Spitalit pas faturimit fillestar;

- d. Nëse individi ka paraqitur një aplikim të paplotë për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm, i jep individit një njoftim me shkrim ku përshkruhet informacioni dhe/ose dokumentacioni i nevojshëm që duhet paraqitur për të plotësuar aplikimin për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm, duke përfshirë të dhënat e kontaktit;
 - e. Përpilon dhe dokumenton një përcaktim kualifikueshmërie për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm sapo individi paraqet një aplikim të plotë për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm, në përputhje me Politikën për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm.
5. Para se të përfshihet në ndonjë masë ECA, Spitali, Agjencia ose Konsulenti i Jashtëm, sipas rastit, vlerësojnë kualifikueshmërinë e individit për programe shtetërore, duke përfshirë programet e sigurimit, si "Medicare" dhe "Medicaid", burime të tjera pagesash dhe Kujdesin Shëndetësor të Përballueshëm.
 6. Spitali, Agjencia dhe Konsulenti i Jashtëm pranojnë aplikimet për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm në çdo kohë gjatë procesit të faturimit dhe të mbledhjes. Nëse një individ paraqet një aplikim të paplotë gjatë ose pasi është ndërmarrë një masë ECA, Spitali, Agjencia dhe Konsulenti i Jashtëm, sipas rastit, e pezullojnë këtë masë ECA derisa të jetë përcaktuar nëse individi kualifikohet për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm dhe ka përmbushur kërkesat e kësaj Politike dhe të Politikës për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm.
 7. Nëse një individ paraqet një aplikim të plotë gjatë periudhës së aplikimit (d.m.th. në çdo kohë përgjatë ciklit të faturimit dhe të mbledhjes), Spitali, Agjencia dhe Konsulenti i Jashtëm, sipas rastit, bëjnë përpjekje të arsyeshme për të përcaktuar nëse individi kualifikohet për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm dhe veprojnë si më poshtë:
 - a. Pezullojnë masat ECA për marrjen e pagesës për kujdesin shëndetësor në përputhje me këtë Politikë Mbledhjeje;
 - b. Përcaktojnë nëse individi kualifikohet për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm dhe e njoftojnë me shkrim individin për këtë përcaktim kualifikueshmërie (duke përfshirë, sipas rastit, ndihmën për të cilën kualifikohet individi) dhe arsyetimin për përcaktimin nga Spitali;

NewYork-Presbyterian Hospital
Vendi: Të gjitha qendrat
Politikat e Spitalit dhe manuali i procedurave
Numri: C190
Faqja 5 nga 8

- c. Nëse Spitali, Agjencia ose Konsulenti i Jashtëm, sipas rastit, përcakton se individi kualifikohet për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm përveç kujdesit falas, Spitali:
- (i) I jep individit një deklaratë faturimi ku tregohet shuma që duhet të paguajë individi për kujdesin shëndetësor dhe mënyra e përcaktimit të kësaj shume, si dhe ku deklarohet ose përshkruhet mënyra se si individi mund të marrë informacion lidhur me shumat e faturuara në përgjithësi (amounts generally billed, AGB) për kujdesin shëndetësor;
 - (ii) I rimbursos individit shumat që ka paguar për kujdesin shëndetësor (qoftë pranë Spitalit ose pranë palëve të cilave Spitali i ka transferuar borxhin e individit për kujdesin shëndetësor) që tejkalojnë shumën për të cilën ai ose ajo është përcaktuar personalisht përgjegjës/e, nëse shuma është më e madhe se \$ 5,00 (ose ndonjë shumë tjetër të caktuar nëpërmjet njoftimit ose udhëzimeve të tjera të publikuara në buletinet e të ardhurave të brendshme);
 - (iii) Merr të gjitha masat e arsyeshme në dispozicion për të anuluar masat ECA të ndërmarra kundrejt individit për marrjen e pagesës për kujdesin shëndetësor. Në përgjithësi, këto masa përfshijnë, por nuk kufizohen me, masat për: (a) shfuqizimin e vendimeve gjyqësore kundër individit, (b) heqjen e të drejtave të mbajtjes së pronës ose të konfiskimit (përveç të drejtave që gëzon Spitali sipas legjislacionit kombëtar për fitimet nga një vendim gjyqësor, marrëveshjeje ose kompromis që i takojnë një individi (ose përfaqësuesit të tij/saj) si rrjedhojë e lëndimeve personale për të cilat Spitali ka ofruar kujdes shëndetësor, (c) heqjen nga raporti i kreditimit të individit të çdo informacioni negativ që është raportuar pranë një agjencie raportimi për konsumatorët ose një byroje kredie.
8. Agjencia dhe Konsulenti i Jashtëm, sipas rastit, do të pezullojnë të gjithë aktivitetet e mbledhjes në lidhje me llogarinë e një pacienti nëse individi kundërshton (në përputhje me procedurat e dhura të Spitalit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve) shumën ose vlefshmërinë e balancës së papaguar. Llogaria e pacientit do të mbetet e pezulluar derisa Spitali të përcaktojë se tentativat për mbledhje mund të rifillojnë. Agjencia ose Konsulenti i Jashtëm nuk kryejnë aktivitete mbledhjeje kundrejt një individi për të cilin Agjencia ose Konsulenti i Jashtëm kanë marrë njoftim falimentimi.

9. Agjencia ose Konsulenti i Jashtëm nuk mund të marrin masa ligjore të asnjë lloji, duke përfshirë lëshimin e një fletëthirrjeje pa marrë autorizimin paraprak me shkrim nga Spitali.

C. Praktikrat e ndaluara të mbledhjes. Spitali, Agjencitë e Mbledhjes dhe Konsulenti i Jashtëm:

1. Nuk do të detyrojnë shitjen ose heqjen e të drejtës së pronës për banesën kryesore të një individi për të paguar një borxh të prapambetur.
2. Nuk do t'i dërgojnë faturë një agjencie mbledhjeje ndërkohë që një aplikim i plotësuar për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm (duke përfshirë dokumentacionet mbështetëse) dhe i paraqitur në Spital është në pritje të një përcaktimi.
3. Nuk do të lejojnë mbledhjet nga një individ që kualifikohej për "Medicaid" gjatë kohës së ofrimit të shërbimeve dhe për të cilat ofrohet pagesë nga "Medicaid", me kusht që individi të ketë paraqitur një aplikim të plotësuar për "Medicaid" në lidhje me këto shërbime.
4. Nuk do t'ia shesin një pale të tretë borxhin e individit.
5. Nuk do t'i raportojnë informacion negativ një agjencie kreditimi. Megjithatë, në përputhje me Politikën për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm, një agjencie kreditimi mund t'i drejtohen pyetje lidhur me kualifikueshmërinë e supozuar për Kujdes Shëndetësor të Përballueshëm.

D. Praktikrat pas gjykimit. Konsulenti i Jashtëm:

1. Do të kryejë vlerësime të gjykimeve rast pas rasti. Nuk lejohet dhe nuk do të kryhet manipulimi elektronik i të dhënave në mënyrë anonime.
2. Nuk do të shkaktojë arrestimin e një individi ose ta bëjë individin objekt të një urdhri për paraqitje në gjykatë.
3. Nuk do të vazhdojë gjykimet pas pesë vjetësh pa miratimin paraprak nga Spitali.
4. Nuk do të zbatojë një gjykim kundër një individi pas pesë vitesh nga data e gjykimit pa miratimin paraprak nga Spitali.
5. Nuk do të rinovojë një gjykim kundër një individi pa miratimin paraprak nga Spitali.

NewYork-Presbyterian Hospital
Vendi: Të gjitha qendrat
Politikat e Spitalit dhe manuali i procedurave
Numri: C190
Faqja 7 nga 8

6. Nuk do të transferojë llogari individuale tek një agjenci tjetër mbledhjeje ose firmë ligjore pa miratimin paraprak me shkrim nga Spitali. Pasi janë bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të identifikuar mbulimin ose pagesën për borxhin dhe pas marrjes së miratimit me shkrim nga Spitali, Agjencia mund t'ia transferojë llogaritë përkatëse Konsulentit të Jashtëm për masa të mundshme ligjore. Llogaritë përkatëse për çdo individ duhet të kenë vlerë kumulative prej të paktën 800 \$ ose vlerë tjetër më të lartë kufi siç përcaktohet herë pas here me shkrim nga Spitali për t'ia transferuar Konsulentit të Jashtëm. Në përgjithësi, transferimi i një llogarie nuk duhet të ndodhë derisa të kenë kaluar gjashtë muaj nga marrja e llogarisë nga Agjencia.
7. Në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kjo Politikë Mbledhjeje dhe Politika e Spitalit për Kujdes Shëndetësor të Përbalueshëm mund të lëshojnë fletëthirrje në gjyq me ose pa njoftim ndalimi për:
 - a. Bankat;
 - b. Vendin e punësimit;
 - c. Kompanitë e kartave të kreditit; dhe/ose
 - d. Kompanitë hipotekare
8. Duke qenë subjekt i kërkesave të kësaj Politike Mbledhjeje dhe Politikës për Kujdes Shëndetësor të Përbalueshëm, mund të lëshojë urdhër përmbarimi mbi pasurinë ndaj llogarive bankare të individit, përveçse ndaj llogarive me tatim të shtyrë ose llogarive të ngjashme të kursimeve për pension. Nëse individi kontakton me Konsulentin e Jashtëm dhe ankimon dhe ofron prova të arsyeshme të vështirësive financiare si pasojë e urdhrit të përmbarimit mbi pasurinë, Konsulenti i Jashtëm mbyll procesin e përmbarimit dhe heq dorë nga garancitë spitalore.
9. Duke qenë subjekt i kërkesave të kësaj Politike Mbledhjeje dhe Politikës për Kujdes Shëndetësor të Përbalueshëm, në përputhje me legjislacionin e Shtetit të Nju-Jorkut, mund të lëshojë urdhra përmbarimi mbi të ardhurat për individin deri në masën dhjetë për qind (10%) të pagës së individit. Konsulenti i Jashtëm nuk është i autorizuar që të lëshojë urdhër ekzekutimi mbi të ardhurat për bashkëshortin/bashkëshorten e një individi.

PËRGJEGJËSIA: Shërbimet financiare të pacientit

DATAT E POLITIKAVE:

NewYork-Presbyterian Hospital
Vendi: Të gjitha qendrat
Politikat e Spitalit dhe manuali i procedurave
Numri: C190
Faqja 8 nga 8

PUBLIKUAR: Tetor 2015

RISHIKUAR: Gusht 2017

Miratimet: Bordi Mbikëqyrës